



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) si dhe nenit 40.paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit Për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040,nenit 16.pika 8.2 të ligjit për buxhet për vitin 2022,nenit 92 të Statutit të Komunës,si dhe propozim-vendimit 01-06-12130/22 .Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: 06.05.2022.mori këtë:

VENDIM

PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KRIJIMIN E KODIT TË RI PARTICIPIM MË DONATOR DHE KOMUNITET

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për shtim të buxhetit në shumë prej: **19.185,00 €.** (Nëntëmbëdhjetëmijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë euro) dhe krijimin e **kodit të ri**, participim më donator dhe komunitet për bashkëfinancimin e një projekti në nivel lokal.
2. Projekti i ri do të krijohet më fondet nga kodi i projektit për bashkëfinancim, bazuar në kontratat e nënshkruara në mes të komunës dhe komunitetit/donatorëve të cilët janë përfitues të serave bujqësore.
3. Për zbatimin e vendimit do të kujdeset, kryetari i komunës, të cilin vendim e zbaton Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.
4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit në kuvendin e komunës, sipas rregullores (QRK)Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, MAPL, Ministria e Financave dhe Transfereve, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-15115 /22
Klinë me 12.05 /22



Kryesuesi,
Fadil Gashi